



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 1267 Prot

Tiranë, më 27 / 7 / 2021

REKOMANDIM

Nr. 26, datë 27 / 7 / 2021

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS  
SË AUTORITETIT PUBLIK “BASHKIA LEZHË”

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 6 dhe 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe shkronjave e) dhe f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”), Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare: <https://lezha.gov.al/programi-i-transparences/>, të Autoritetit Publik “Bashkia Lezhë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në pikën 1, të nenit 4 të LDI parashikohet se: “*Autoriteti Publik vë në zbatim një program institucional të transparencë, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni*”.

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: “*Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi...*”.

Në zbatim të nenit 6 më sipër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e

*Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore*". Në bazë të pikës 2 të këtij Urdhri, "Autoriteti Publik/Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore zbatojnë programin institucional të transparencës jo më vonë se data 1 janar 2019". Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm të tij me informacion dhe dokumentacion publik, në referencë edhe të pikës 2, të nenit 5 të LDI.

Me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrimit ligjor të sipërcituar, Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës, pranë Zyrës së Komisionerit, kreu monitorimin online të faqës zyrtare të Autoritetit Publik.

Nga monitorimi i kryer u konstatua se faqja e re e Autoritetit Publik është në ndërtim e sipër. Në menunë kryesore është publikuar ikona "Home" ku në brendësi të saj rezulton i publikuar në format PDF Programi i Transparencës. Ky format në brendësi të tij ka të dhëna vetëm për koordinatorin për të drejtën e informimit i cili mban edhe funksionin e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. Ky format i publikuar është në përputhje me modelin e miratuar me Urdhrin e Komisionerit nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore".

Nga verifikimi në brendësi i rubrikave të veçanta, rezulton se në këtë format nuk është pasqyruar/ndërlidhur informacioni, sipas kategorive pjesë përbërëse të programit të transparencës, të përcaktuara në Urdhrin e Komisionerit nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore", si dhe nenin 7 të LDI.

Konkretisht, rezultojnë të papublikuara dhe/ose të pandërlidhura me programin e transparencës kategori informacion/dokumentacion publik në lidhje me organizimin dhe funksionimin e bashkisë, transparencën dhe llogaridhënien ekonomiko-financiare, trajtimin e kërkesave për informacion, shërbimet që ofron bashkia, legjislacionin e zbatueshëm nga autoriteti publik, pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje.

Bashkëlidhur këtij Rekomandimi, në Lidhjen nr. 1, e cila konsiderohet pjesë përbërëse e këtij Rekomandimi, gjendet raporti i plotë i monitorimit të zbatimit të programit institucional të transparencës nga ana e Autoritetit Publik, në të cilin janë pasqyruar të detajuara gjetjet dhe konstatimet përkatëse të monitorimit.

Në këtë raport monitorimi, është pasqyruar vetëm informacioni i cili është i publikuar/ndërlidhur me formatin e programit të transparencës.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se kategori të caktuara të informacionit, pjesë e programit të transparencës, rezultojnë të publikuara në faqen zyrtare të Autoritetit Publik, ky i fundit duhet t'i përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për

miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, sipas gjetjeve të pasqyruara në lidhjen nr. 1 të këtij Rekomandimi.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë. Nga ana tjetër, Programi Model i Transparencës përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës së autoriteteve publike dhe çdo autoritetit është i detyruar ligjërisht t’a zbatojë atë.

Po ashtu, njësitë të vetëqeverisjes vendore i’u lind detyrimi për bërjen transparente të veprimtarisë së tyre, edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar. Bazuar në nenin 15 të ligjit të mësipëm “Transparenca e veprimtarisë së njësitë të vetëqeverisjes vendore”, parashikohet se:

*“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.*

*2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike...”.*

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 6 dhe 7 të LDI dhe shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, nga monitorimi i kryer,

### **REKOMANDOJ :**

1. Autoriteti Publik/Bashkia Lezhë, të pasqyrojë/ndërlidhë në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas Lidhjes nr. 1 të këtij Rekomandimi.
2. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, “*Institucionet publike dhe private bashkëpunojnë me Komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave, si dhe e njoftojnë atë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna, menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar për kryerjen e tyre*”, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij Rekomandimi, brenda datës 30 shtator 2021.

3. Në mbështetje të nenit 31/1, pika c të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, pas përfundimit të afatit të mësipërm, Komisioneri do të nisë hetimin e nevojshëm administrativ.
4. Në rast mospërbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron në përputhje me nenet 18 dhe 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 27. 7.2021

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

